



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:097267

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06325660

KF.nr.529/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit “Euro Assets Advisory” Sh.A, me numër unik identifikues 811316589, dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Hoxha, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti tatim shtesë, vlerë kontesti 171,758.71 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Ekrem Hoxha avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 18.09.2024, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Euro Assets Advisory” Sh.A, me seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET vendimi nr.27/2021 i datës 12.03.2021 i të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësin, “Euro Assets Advisory” Sh.A, me seli në Prishtinë ta liroj nga detyrimit i pagesës së tatimit shtesë për TVSH në shumë prej 9,277.19 €, në emër të ardhurave të korporatave në shumë prej 161,481.53 euro, si dhe në emër të ndëshkimit në shumë prej 1,000.00 euro, gjithsej në shumë prej 171,758.71 euro (njëqindën e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqindën e pesëdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e një cent).
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 21.05.2021, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër vendimit nr.27/2021 i datës 12.03.2021, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia, të anulohet në tërësi vendimi i kundërshtuar, të lirohet paditësi nga detyrimi i pagesës së tatimit shtesë në shumë prej 170,758.71 euro, dhe nga ndëshkimi administrativ MFA2R00000109681 në lartësi prej 1,000.00 euro, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm. Në seancën e shqyrtimi gjyqësor-kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se nga prova e ekspertizës e dorëzuar në gjykatë po që se i referohemi konstatimeve dhe mendimeve të ekspertizës financiare faqe 24 par 4 eksperti ka konstatuar se edhe kontrollat tatimore ka bërë gabim duke i konsideruar si shitje deklarimet e T/P mbi bazën e pro faturave siç e ka bërë ish kontabilisti i paditësit. Në interpretim të gabuar të ligjeve të aplikueshme dhe të deklarimeve tatimore ATK-ja në procedurat e ankimimit është dashur që të eliminojë këtë anomali por e njëjta si gjithmonë bazuar në praktikën tonë korrigjimet dhe ndryshimet i lënë me një arsyetim të përgjithshëm që gjykata të vendos mbi këto mos pajtime. Po që se lexohet ekspertiza në shpalosje të saj ndërlidhur me këtë konstatim kryesor referuar faqeve 13-21 gjykata do e gjej se pretendime të paditësit janë të bazuara në prova materiale dhe ligje të aplikueshme. Kjo është konstatuar edhe me aktgjykimin paraprak nga Gjykata Themelore me provën e aktgjykimit të bashkangjitur kësaj lënde. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se siç e kemi provuar gjatë procedurës me prova materiale konstatojmë se rasti në procedurë është rast i gjykuar dhe e paditura nuk e ka ekzekutuar aktgjykimin e formës së prerë duke u thirrur në një dispozitë ligjore e cila i obligon T/P që të drejtat e saj të fituara në procedura të gjata gjyqësore të detyrohet të iniciojë kontest të ri si në rastin tonë. Për këtë arsye bazuar në prova të pa kundërshtueshme të ekspertizës financiare dhe trajtimit të gabuar të transaksioneve investitori japonez (T/P) për blerjen e pronave e paditura i ka cilësuar si shitje dhe i ka ngarkuar me tatime dhe ndëshkim gjersa gjykatës i është provuar se tatimpaguesi ka kryer blerjet të cilat janë të pa tatueshme andaj në thirrje të parimit kryesor ligjor të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe zbatueshmërisë të aktgjykimeve kërkojmë nga gjykata që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, të anulohet në tërësi vendimi i kundërshtuar nga ATK me nr.27/2021 i datës 12.03.2021 së bashku me vendimin e ATK nr.602/2016 dhe njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë në TVSH dhe CD të evidentuara me nr. si

në vijim: 16998596, 16998620, 19698637, 16998641, 16998648, 17002229, 17002230 dhe masa ndëshkuese me nr. MFA2R 00000109681 si dhe përfundimisht të lirohet paditësi nga detyrimi i pagesë së tatimit shtesë në vlerën totale prej 170,758.71 euro dhe ndëshkimi administrativ në lartësi prej 1,000.00 euro si dhe çdo interes i kalkuluar mbi këto tatime të ngarkuara ndaj paditësit nga e paditura si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padinë të datës 09.11.2021, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura të paditësit, si të pabazuar në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se Vendimi i DA të ATK-së nr.27/2021 datë 12.03.2021 është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje ka theksuar se pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Raporti i Kontrollit me nr.54 datë 30.11.2016, vendimi i Divizionit të Ankesave nr.602/2016 datës 13.02.2017, Ankesa në Divizionin e Ankesave nr.602/2016 datës 27.12.2016, pro faturave, ekstrakteve bankare, dokumenteve nga dosja e tatimpaguesit me theks të veçantë tabelës së pagesave dhe kthimi në llogari bankare, dokumentit mbi vendosjen e ndëshkimit MFA2R 00000109681 datës 30.11.2016, aktiviteti formë për vizitë e përmbushjes datë 10.03.2015 duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata në Aktgjykimin A.nr.484/17 datës 05.10.2020, ka vendosur se ankesa është e pabazuar. Këtë vendosje ATK-ja e mbështet për faktin se: Vlerësimi i kontrollit për tatim shtesë është bërë bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga paditësi/tatimpaguesi dhe nga krahasimi me informata nga palët e treta bazuar në nenin 19, paragrafi 2 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditura e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 13.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, ka administruar provat relevante dhe atë: Certifikatë e regjistrimit nga ARBK për paditësin e datës 09.02.2015 së bashku me informatat mbi biznesin, Kontratë për shitblerje të paluajtshmërisë LRP.nr.486/2013, LRP.nr.1054/2013, VR.nr.4142/2012, VR.nr.4146/2012, VR.2.nr.570/2013, Certifikata nga

Regjistrat Kadastrale me nr. 4313-2013 për ngastrën 01451-0, 01454-0, 0164-0, Fletë kthesa mbi pranimin e aktvendimit kontestues vendim nr.27/2021 datës 12.03.2021, Aktgjykim A.nr.484/17, Vendim 602/2016 datës 13.02.2017, Dokumenti i vendosjes së ndëshkimit datës 30.11.2016, Përgjigje në padi datës 09.11.2021, Aktiviteti AU 001, 002,003, Forma për vizitat përmbushëse datës 10.03.2015, Informatat nga Pro Credit Bank, Pro faturat, Faturat e shërbimeve në periudha tatimore, Transferet ndërkombëtare, Certifikatë nga Regjistri Kadastral nr.011953-63062/2013, Raport i kontrollit datës 30.11.2016, Vendosja e ndëshkimit MFA2R00000109681, Ankesë në DA të ATK datës 27.12.2016, dhe Ekspertizë financiare e punuar për lëndën A.nr.484/17.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjen në padi, shkresave të lëndës në këtë Kontest Tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë Kontest Tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresave të lëndës, vendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka kryer kontroll tek paditësi. Po ashtu nuk janë kontestuese edhe faktet se paditësi pas pranimit të Njoftim Vlerësimeve me datë 27.12.2016 ka paraqitur ankesë në Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila me datën 13.02.2017 ka marrë vendimin nr.602/2016, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit, e kundër këtij vendim paditësi ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila e me datë 05.10.2020 ka marrë Aktgjykimin A.nr.484/17 me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, e ka anuluar pjesërisht vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës nr.602/2016 të datës 13.02.2017, ashtu që lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje për qarkullim dhe tatim shtesë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave, ndërsa e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë sa i përket njohjes së shpenzimeve operative të biznesit për vitet 2012 dhe 2013. Jo kontestues mbetet edhe fakti se ATK-ja duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.484/17 ka marrë vendimin nr.27/2021 të datës 12.03.2021 me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit, e kundër të cilit vendim paditësi me padinë e datës 21.05.2021, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesave, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit dhe ka lënë në fuqi njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë për qarkullim shtesë në TVSH dhe CD, me arsyetim se bazuar në shkresat e lëndës është vërtetuar drejtë gjendja faktike në momentin kur kontrolli ka vlerësuar se pro faturat dhe pagesat në emër të këtyre pro faturave të bëra përmes transfereve bankare nga persona fizik (qytetar nga Japonia) për blerje të tokës i ka trajtuar si shitje për qëllime tatimore për faktin se bazuar në nenin 10 paragrafin 1 të Ligjit 03/L-146 për TVSH është plotësuar kriteri ligjor për transferimin e të drejtës për të disponuar me pasuri materiale si pronar, andaj me të drejtë është vlerësuar se të hyrat e tilla janë të ardhura të tatueshme për TAK sipas nenit 5, paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-162 për TAK. Gjithashtu është theksuar se nuk mund të provohet se vet tatimpaguesi e ka ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH, respektivisht të gjitha blerjet i ka deklaruar si blerje pa TVSH, andaj përderisa tatimpaguesi nuk ka ushtruar të drejtën për zbritje të TVSH-së kontrolli ka vepruar në harmoni të plotë me dispozita ligjore, respektivisht nenin 38, paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-146 për TVSH në lidhje me kufizimet kohore për të ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Në lidhje me ndëshkimet administrative sipas dokumentit të vendosjes së ndëshkimit me nr. MFA2R00000109681, DA pas analizimit të shkresave të lëndës ka vendosur se tatimi shtesë ka rrjedhë si rezultat i mos mbajtjes, respektivisht mos krijimit të saktë të librave dhe regjistrimeve sipas nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 andaj shqiptimi i ndëshkimit administrativ në vlerë prej 1,000.00 euro, sipas nenit 53 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 është vërtetuar si i bazuar.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e aktit përfundimtar të të paditurës, përkatësisht vendimin kontestues nr.27/2021, konstaton se e paditura edhe përkundër obligimeve nga aktgjykimi A.nr.484/17 nuk i ka përfillur vërejtjet e dhëna në të njëjtin, ashtu që në vendimin kontestues ka ritheksuar të gjeturat e njëjta si në vendimin paraprak. Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura nuk i është përgjigjur vërejtjeve të Gjykatës të dhëna në aktgjykimin A.nr.484/17, ku përsëri ka theksuar se pro faturat dhe pagesat në emër të këtyre pro faturave të bëra përmes transfereve bankare nga persona fizik (qytetar nga Japonia) për blerje të tokës i ka trajtuar si shitje për qëllime tatimore, duke mos arsyetuar udhëzimin e dhënë me aktgjykimin e lartcekur, se e paditura duhet të vërtetonte saktë faktin se nëse paditësi ka realizuar transaksione të shitblerjes së pronave tek investitor japonezë nga të cilët ka pranuar mjetet financiare në llogarinë bankare, po duke pasur parasysh edhe librin e stokut të paditësit

dhe tokën të cilën i njëjti e disponon në libra dhe regjistrime të biznesit dhe jo të mjaftohej vetëm në konstatimin e lëshimit të pro faturave nga ana e paditësit dhe pagesave të pranuar. Po ashtu e paditura nuk e ka përfillur as vërejtjet tjera të dhëna me aktgjykimin e lartcekur edhe atë për TVSh-në e zbritshme, sepse edhe në këtë rast në vendimin nr.27/2021 vetëm ka theksuar se nuk mund të provohet se vet tatimpaguesi e ka ushtruar të drejtën e zbritjes së TVSH-së, respektivisht të gjitha blerje i ka deklaruar si blerje pa TVSH, edhe i ka mjaftuar vetëm thirrja në nenin 39, paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-146 për TVSH.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 par 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga dispozitat ligjore të lartcekura, Gjykata konsideron se barra e provës bie mbi palët ndërgjyqëse.

E paditura nuk e ka konstatuar saktë nëse paditësi ka realizuar transaksione të shitblerjes së pronave tek investitorët japonez, nga të cilët ka pranuar mjete financiare në llogari bankare, përfshirë edhe librin e stokut të paditësit dhe tokën të cilën i njëjti e disponon në libra dhe regjistrime të biznesit.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamje ligjore, për ta liruar nga detyrimi i pagesës së tatimit shtesë për TVSH në shumë prej 9,277.19 €, në emër të ardhurave të korporatave në shumë prej 161,481.53 euro, si dhe në emër të ndëshkimit në shumë prej 1,000.00 euro, gjithsej në shumë prej 171,758.71 euro (njëqindën e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqindën e pesëdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e një cent). Prandaj Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par. 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe e anuloi vendimin e kontestuar, duke e obliguar të paditurën që paditësit ta liroj nga detyrimi i pagesës së tatimit shtesë për TVSH, në emër të ardhurave të korporatave si dhe në emër të ndëshkimit gjithsej në shumë prej 171,758.71 euro

(njëqindën e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqindën e pesëdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë e një cent).

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. *“Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”, paragrafi 2. “Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”. Paragrafi 3. “Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”, paragrafi 4. “Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”, dhe paragrafi 5. “Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendos edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”.*

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.529/22 datë 18.09.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.